

INFORMACION PËR TË MITURIT VIKTIMA TË NJË VEPRE PENALE

INFORMACION PËR TY QË JE VIKTIMË E NJË VEPRE PENALE

LETRA E TË DREJTAVE

Kjo Letër e të Drejtave rendit dhe shpjegon të drejtat e tua si i mitur viktimë e një vepre penale.

Ti ke të drejtat e mëposhtme:

1. Të kërkosh që të fillojë hetimi ndaj personit që ti beson se është përfshirë në një veprë penale ndaj teje.
2. Nëse dëshiron mund të kërkosh kujdes shëndetësor, ndihmë nga një psikolog ose ndihmë tjetër që të nevojitet si viktimë.
3. Nëse nuk flet ose kupton shqip, ke të drejtë për shërbim interpretimi/përkthimi falas në çdo moment që flet me policinë gjyqësore ose prokurorinë ose ne momentin që intervistohesh (pyetesh). Gjithashtu ke të drejtë të marrësh një kopje të Letrës së të Drejtave në një gjuhë që ti flet ose kupton. Nëse nuk të jepet përkthimi, informacioni duhet të të jepet përmes një interpreti dhe përkthimi duhet të të jepet sa më shpejt që të jetë e mundur. Policia Gjyqësore do të caktojë një interpret të gjuhës së shenjave për të të ndihmuar, nëse është e nevojshme.
4. Të mbrohesh me avokat gjatë gjithë hetimit. Policia Gjyqësore dhe prokurori janë të detyruar të sigurojnë në çdo rast mbrojtjen me avokat. Avokati e njuh ligjin dhe mund të të ndihmojë dhe të të këshillojë. Shumë njerëz kërkojnë që të flasin me avokatin. Mund të marrësh avokat falas, ose nëse dëshiron, mund të zgjedhësh avokatin që e paguan vetë. Fol me policinë gjyqësore ose prokurorin për këtë çështje.
5. Policia Gjyqësore, në çdo moment, duhet të të shpjegojë se çfarë po ndodh me rastin tënd dhe të të tregojë të gjitha provat dhe dokumentet. Mund të ndodhë që policia gjyqësore dhe prokurori të ta mohojnë këtë të drejtë nëse është e rëndësishme që të mos nxirret informacion për hetimin në proces.
6. Nëse dëshiron, mund të kërkosh që policia gjyqësore ose prokurori të hetojë çdo rrethanë që mendon se është e rëndësishme për çështjen tënde.

7. Të informohesh për arrestimin ose lirimin e çdo personi të përfshirë në çështjen tënde.
8. Të informohesh nëse vendoset mosfillimi ose pushimi i hetimit të çështjes tënde dhe për fillimin dhe mbarimin e çështjes të dërguar në gjykatë.
9. Nëse dëshiron mund të kërkoh ndryshimin e çdo vendimi të marrë gjatë hetimit ose pasi prokurori ose gjykata të ketë marrë një vendim.
10. Të kërkoh dhe të shpjegohet se çfarë duhet të bësh nëse dëshiron të kërkoh për kompensim të dëmit të pësuar.
11. Të marrësh të gjitha njoftimet për dokumentacion dhe të depozitosh kërkesën falas.
12. Të ftohesh në seanca dëgjimore dhe gjyqësore.
13. Të pyetesh në gjykatë nëse dëshiron. E ke këtë të drejtë edhe nëse nuk të kërkohet.
14. Të ndihmohesh nga një psikolog gjatë gjithë fazës së hetimit. Ndaj mos hezito të kërkoh ndihmën e tij/saj në çdo moment.
15. Nëse dëshiron, prindërit ose një person tjetër i besuar mund të qëndrojnë me ty gjatë hetimit.
16. Ti ke të drejtë që emri dhe çdo informacion tjetër për ty të mbahet i fshehtë që të shmanget identifikimi yt nga publiku.
17. Të intervistohesh menjëherë nga një punonjës policie ose prokuror i të njëjtit seks me ty nëse je viktimë e abuzimit seksual ose trafikimit. Gjithashtu ke të drejtë të refuzosh t'u përgjigjesh pyetjeve për jetën tënde private që qartazi nuk kanë lidhje me veprën penale. Avokati mund të të tregojë nëse ka ndonjë pyetje që mund të refuzosh t'i përgjigjesh.
18. Të intervistohesh në një sallë me kamera dhe mikrofon nëse je viktimë e abuzimit seksual ose trafikimit.
19. Ti gjithashtu ke të drejta të tjera të shpjeguara në ligj që avokati ose person tjetër i besuar mund të të shpjegojë.

Unë e mora letrën e të drejtave të të miturit viktimë, sot më datën _____

I MITUR VIKTIMË
